

TIPARET MBISEGMENTALE NË LETËRSINË PËR FËMIJË DHE PËRKTHIMI I TYRE NË SHQIPE

Dr. Aida Alla

Departamenti i Gjuhës Angleze
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Kolegji AAB,
E-mail: aida.aalla@aab-edu.net

PËRMBLEDHJE:

Tiparet mbisegmentale, si fenomene akustike të mbivendosura në tingujt e ligjërit, studiohen nga fonetika. Megjithatë, tipare të tilla si toni, intonacioni, theksi, variacionet në diksion, ndalesat etj. zëvendësohen me forma grafike kur ligjërimi i folur kthehet në formën e shkruar. Prania e tyre në letërsi është shumë e rëndësishme, duke pasur parasysh funksionet semantike të cila përcjellin. Ky studim ka për synim që fillimisht të studiojë mjetet grafike të cilat zëvendësojnë tiparet mbisegmentale si edhe të shqyrtojë funksionet e tyre në letërsi në tri romanet e para “Harry Potter”. Së dyti, variantet e përkthyer të tri romaneve të para “Harry Potter” në shqip do të shqyrtohen përmes një analize kontrastive, me qëllim që të vërtetojmë nëse aspekti grafik i tipareve mbisegmentale si edhe funksionet e tyre në letërsi janë ruajtur gjatë procesit të përkthimit, në mënyrë që lexuesi i vogël në tekstin e përkthyer të kuptojë shtresimet konotative të kuptimit në tekstin burimor.

Fjalët çelës: tipare mbisegmentale, mjete grafike, analizë kontrastive, efekti i njëjtë

ABSTRACT:

Suprasegmental features, as acoustic phenomena imposed on speech sounds, can be considered a domain of phonetics. However, such features like tone, intonation, stress, variations in diction, pauses etc. are replaced by graphics when the spoken discourse is rendered into the written form. Their presence in literature is very important considering the semantic functions they entail. The aim of this paper is twofold. Firstly, it attempts to study the graphical tools that replace the suprasegmental features as well as their functions in literature in the first three Harry Potter novels. Secondly, the translated variants of Harry Potter into Albanian will be looked upon through the comparative analysis, with the aim of investigating whether the graphical aspect of suprasegmental features along with their functions are preserved during translation, so that the child reader of the target text receives the connotative layers of intended meaning.

Keywords: suprasegmental features, graphic tools, contrastive analysis, similar effect

Hyrje

Tiparet mbisegmentale, gjithashtu të njohura me termin “elemente prozodike”¹, si njësi akustike të cilat u mbivendosen njësive fizike të tingujve², konsiderohen si dukuri e ligjërimit bisedor dhe studiohen nga fonetika. Letërsia, ndonëse një mjet komunikimi i shkruar, ngërthen në tërësinë e saj dialogje dhe ligjërime bisedore, tiparet mbisegmentale të të cilave shprehen me anë të grafikave që zëvendësojnë variantin akustik të tyre. Ky punim synon të studiojë tipologjinë dhe funksionet e këtyre tipareve në gjuhën burimore dhe më pas të vëzhgojë nëse këto tipare janë ruajtur edhe në gjuhën e përkthimit. Ky studim bazohet mbi metodën deskriptive dhe atë analitiko-kontrastive. Tri romanet e para të serisë Harry Potter do të shërbejnë si korpus i këtij studimi përfaqësues. Shembujt janë përzgjedhur në bazë të kriterit të shumëllojshmërisë së formave dhe funksioneve dhe jo në bazë të dendurisë së tyre.

Sipas Christiane Nord-it, tiparet mbisegmentale janë të gjitha ato tipare të një organizimi tekstor, të cilat vendosen mbi segmentet leksikore dhe sintaksore, mbi fjalitë dhe paragrafët, duke krijuar kështu kornizën e konfigurimit fonologjik ose tonin e veçantë të tekstit. Korniza e veçantë e një teksti varet, mbi të gjitha, nga mjeti i komunikimit me të cilin ky tekst përcillet. Në tekstet e shkruara tiparet mbisegmentale shprehen me anë të mjeteve pamore, siç janë fjalët me shkronja kursive, hapësirat apo fjalët me shkonja të zeza, shenjat e pikësimit dhe citimit, vizat, parantezat, etj. Në gjuhën e folur, tiparet mbisegmentale shprehen me anë të mjeteve akustike, siç janë intonacioni, variacionet në shqiptim dhe volum etj.³

Këto mjete grafike me kuptim plotësues janë trajtuar edhe nga studiuesi Xhevat Lloshi në librin e tij të titulluar «Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika». Ai shprehet se «Ndryshimet e drejtshkrimit ngjallin reagime deri emocionale. Trajtat shkrimore përbëjnë grafemikën, që e studion grafematika.⁴» Në korpusin

- 1 Lazlo Varga, *Introduction to English Linguistics A Companion to the Seminar*, Eötvös Loránd University Budapest 2010, fq. 13.
- 2 B Collins & I. M. Mees, *Practical Phonetics and Phonology: A Resource Book for Students*, 3rd ed. Routledge, 2013, fq. 248.
- 3 C. Nord, *Text Analysis in Translation: Theory, Methodology, and Didactic Application of a Model for Translation-Oriented Text Analysis*, Amsterdam: Rodopi, 2005, fq. 131.
- 4 Xh. Lloshi, *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*. Tiranë: Albas, 2005, fq. 63.

tonë janë të pranishme lloje të ndryshme të trajtave shkrimore, të cilat duke iu kundërvënë normës së ngulitur drejtshkrimore, japin sinjale shtesë përpos kuptimit denotativ, që fjalët e fjalive përkatëse mbartin. Sipas Lloshit, dallojmë dy nivele të grafemikës. I pari ka të bëjë me shkronjat. Dallohen shkronja të mëdha, të vogla, të drejta, të zeza, kursive e të nënvizuara.⁵ Pra shkrimtarët, në varësi të situatës, mund të «luajnë» me kombinime të ndryshme grafike, për të sinjalizuar e krijuar një efekt emocional. Me qëllim që të vihet në dukje diçka, është i zakonshëm përdorimi i shkronjave kursive, ndryshimi i llojit të shkrimit, ndërprerja e fjalëve në rrokje, nëse këto të fundit mund të japin një kuptim të dytë kur përdoren veç e veç etj.

Sipas Lloshit, niveli i dytë ka të bëjë me formësimin e përgjithshëm, që u nënshtrohet teknikave të faqosjes, duke nisur nga formati i letrës, gjerësia e kolonave, hapësirat, titujt, kornizat etj.⁶ Shenjat e pikësimit gjithashtu janë tipare, të cilat studiohen nga grafematika. Lloshi shprehet se në prozën letrare pikësimi lidhet me mënyrat e rrëfimit dhe me evoluimin e llojeve të ligjëratës. Për shembull, thonjëzat që nuk janë vënë për të cituar, shërbejnë për të shprehur ironi. Autorët, qëllimisht, i shkelin rregullat e njohura të pikësimit, ose i përdorin në mënyrë subjektive.⁷

Rëndësia e tipareve mbisegmentale në romanet Harry Potter

Duke qenë se lexuesit parësorë të vëllimit Harry Potter janë fëmijët e grupmoshave nga 9 deri në 14 vjeç, këto mjete pamore, me funksion përcjelljen e informacionit plotësues, do t'i ndihmonin edhe më shumë për të kuptuar tonin dhe nënkuptimet e tjera, të fshehura pas fjalëve. Për shembull, në korpusin tonë ndeshim rëndom fjalë e fjali të shkruara me gërma kapitale, me anë të të cilave lexuesi sinjalizohet për një ndryshim të tonit të fjalisë. Folësi mund të jetë i inatosur, mund të dojë të tërheqë vëmendjen, etj.

Gjithashtu, natyrës së tekstit të karakterizuar nga fantazia dhe prania e magjikes, do t'i shkonte më shumë për shtat që titulli i librit dhe titujt e kapitujve të jepeshin me një lloj të veçantë shkrimi të ngjashëm me atë të papiruseve të vjetra. Kështu do të

5 Po aty.

6 Po aty.

7 Po aty, fq. 64.

krijohej një ngjashmëri dhe një lidhje midis magjikes në libër dhe natyrës mistike që arrijnë të krijojnë shkrimet e vjetra.

Në këtë kuptim, nuk mund të anashkalojmë këto tipare mbisegmentale në korpusin tonë, mungesa e të cilave do të krijonte një boshllëk interpretimi te lexuesit e të dyja varianteve. Në fakt, te romani Harry Potter, këto tipare janë të shumëllojshme si në formë, ashtu edhe në funksione. Më poshtë do të analizojmë disa shembuj të tipareve mbisegmentale të krahasuara edhe me variantin në gjuhën e përkthimit, për të parë nëse këto “sinjalistika” pamore janë të shprehura edhe në gjuhën e përkthimit.

Analiza kontrastive: Ndryshime në llojet e shkrimeve

Siç e shohim nga shembulli i mëposhtëm, shkronjat në tekstin burimor janë dhënë me llojin e shkrimit Edwardian Script ITC, i cili i ngjan më shumë një shkrimi dore. Në gjuhën e përkthimit vërejmë se i vetmi ndryshim është përdorimi i shkronjave kursive, duke iu larguar kështu stilit të tekstit burimor.

KWIKSPELL	Magjivrik
<i>A Correspondence Course in Beginners' Magic</i>	Kurs Magjie me Korrespondencë për Fillestarë
Intrigued, Harry flicked the envelope open and pulled out the sheaf of parchment inside. More curly silver writing on the front page said:	U bë kureshtar, e hapi zarfin dhe nxori prej tij një fletë pergamene. Me shkronja të argjendta, në faqen e parë shkruhej:
<i>Feel out of step in the world of modern magic? Find yourself making excuses not to perform simple spells? Ever been taunted for your woeful wandwork?</i>	<i>Ndiheni mbrapa të tjerëve në botën moderne të magjisë? Jeni kujtuar se përdorni gjithfarëlloj shfaqësimesh, mjaft që të mos kryeni as shortitë më të thjeshta? A ju kanë tallur ndonjëherë për shkak të rezultateve të dobëta të shkopiit tuaj magjik?</i>
<i>There is an answer!</i>	Ja si i përgjigjemi:
<i>Kwikspell is an all-new, fail-safe, quick-result, easy-learn course. Hundreds of witches and wizards have benefited from the Kwikspell method!</i> (HPCS, p.113)	<i>MagjiVrik është kursi më i ri me rezultate të garantuara, të shpejta dhe që përvetësohen me lehtësi. Më qindra magjistarë dhe magjistrica kanë përfutur së tepërmi nga metoda MagjiVrik!</i> (HPDF, 105)

Mund të themi se ndjesia që arrin të krijojë shkrimi i dorës në tekstin origjinal nuk përcillet në tekstin e përkthimit. Për mendimin tonë, do të ishte e udhës të gjendej një mjet grafik për të përcjellë të njëjtin efekt që krijohet tek lexuesi i tekstit origjinal.

Analiza kontrastive: Përdorimi i fjalëve me shkronja kursive

Shkronjat kursive, nga forma, janë të ngjashme me ato të shkrimit të dorës. Në aspektin stilistikor, ato shënjojnë kontrast me shkrimin e drejtë dhe, me anë të kësaj kundërvënieje lexuesi arrin të kuptojë funksionin mbisegmental apo qëllimin e autores. Janë të shumtë shembuj të tillë në sagën Harry Potter, duke filluar nga fjalë të veçanta, deri te fjalitë apo edhe mikrotekste të tëra. Funksionet e tyre janë gjithashtu të shumta. Përdorimi i shkronjave kursive për fjalë të veçanta ka kryesisht funksion emfatik, ose tregon se kemi të bëjmë me një fjalë të huazuar apo një neologjizëm të autores, siç mund të jenë shortitë apo objektet magjike. Mikrotekstet pragmatike që kanë të bëjnë me letërkëmbime, janë dhënë me shkronja kursive. Për shembull, letra joformale që iu dërgua Harrit nga nuni i tij, Sirius Blllek, është shkruar e gjitha me shkronja kursive.

Përpos elementeve gjuhësore, të cilët shënjojnë intimitetin dhe miqësinë që Harri ka me nunin e tij, elementi grafik, përkatësisht shkronjat kursive, e shtojnë këtë dozë intimiteti duke e bërë letrën të duket si të ishte e shkruar me dorë. Ndërkohë, në letërkëmbimet zyrtare vërejmë përdorimin e shkrimit të zakonshëm. Është pikërisht kjo kundërvënie që sinjalizon kalimin nga një situatë formale, në një situatë më intime ligjërimore.

Më poshtë shohim një shembull me fjalë apo fjali me shkronja kursive, të cilat janë përdorur për arsye emfatike:

“This is our last chance — <i>my last chance</i> — to win the Quidditch Cup,” he told them, striding up and down in front of them. “I’ll be leaving at the end of this year. I’ll never get another shot at it. “Gryffindor hasn’t won for seven years now. Wood swallowed, as though the memory still brought a lump to his throat. “But we also know we’ve got the <i>best — ruddy — team — in — the — school</i>,” he said, punching a fist into his other hand, the old manic glint back in his eye. “We’ve got three <i>superb</i> Chasers.” Wood pointed at Alicia Spinner, Angelina Johnson, and Katie Bell. “We’ve got two <i>unbeatable</i> Beaters.” “Stop it, Oliver, you’re embarrassing us,” said Fred and George Weasley together, pretending to blush. “And we’ve got a Seeker who has <i>never failed to win us a match!</i>” Wood rumbled, glaring at Harry with a kind of furious pride. “And me,” he added as an afterthought. (HPPA, p. 115)	Ky është rasti ynë i fundit, rasti <u><i>im</i></u> i fundit për të fituar kupën e Kuidiçit, tha duke u çapitur para e mbrapa. – Në fund të këtij viti do të largohem. Nuk do të kem më rast tjetër. Grifarti ka shtatë vjet që nuk fiton. Bastuni u gëlltit, sikur kujtimet t’ia ngushtonin grykën. – por ne e dimë edhe se skuadra jonë është <u><i>skuadra më e mirë e shkollës</i></u>, - tha duke përplasur grushtin me pëllëmbë të dorës, ndërsa në sy i shkrepinte flakërima e kahershme entuziaste. – Kemi tri gjuajtëse <u><i>të hatashme</i></u>. Bastuni bëri me dorë nga Liza Spineti, Enxhëllin Xhonsoni dhe Ketii Belli. Kemi goditës që <u><i>s’i thyen dot kush</i></u>. Mjaft, Oliver, po na bën të skuqemi, - thanë me një zë Fredi dhe Xhorxhi, duke bërë kinse po e ndjenin veten ngushtë. Dhe një Kërkues <u><i>që na ka çuar gjithnjë në fitore!</i></u> – ushtoi Bastuni duke ia ngulur sytë Harrit me një farë krenarie të papërmbajtur. Pastaj jam edhe unë, - tha mbasi u mendua pak. (HPBA, fq. 111)
--	--

Siç e shohim nga shembulli, aspekti grafik me shkronjat kursive është ruajtur edhe në tekstin e përkthyer, duke e përcjellë efektin emfatik të tyre. Bëhet fjalë për një fjalim të shkurtër që Bastuni mban para lojtarëve të skuadrës së tij dhe roli i tij është t’i motivojë dhe t’i çojë lojtarët e skuadrës drejt fitores. Janë pikërisht fjalët motivuese të tij të cilat janë shënuar me shkronja kursive: *my last chance*; *the best — ruddy — team — in — the — school*; *two unbeatable Beaters*; a Seeker Who has *never failed to win us a match*. Megjithatë, fraza: *best — ruddy — team — in — the — school*”, e cila është e ndarë me viza duke krijuar idenë e një fjale të vetme, nuk është përcjellë si e tillë në gjuhën e përkthimit. Gjithashtu, në po të njëjtën

frazë, mbiemri *ruddy* i përket regjistrin informal (slang-ut) në gjuhën burimore. Do të ishte me vend të gjendej një fjalë me të njëjtën shkallë informaliteti, si për shembull: Skuadra jonë është skuadra më e hatashme e shkollës.

Analiza kontrastive: Përdorimi i fjalëve dhe fjalive me shkronja të mëdha

Fjalët dhe fjalitë me shkronja të mëdha, janë të kudondodhura në vëllimin Harry Potter. Ato përdoren për qëllime stilistikore dhe pragmatike nga ana e autores. Funksionet e tyre janë gjithashtu të shumta. Për shembull, sa herë që kemi ndryshim të gjendjes emocionale të ndonjë personazhi, siç është shprehja e habisë, lumturisë, mllëfit, dhënia e një urdhri apo edhe për arsye emfatike.

Më poshtë kemi një shembull, ku fjalja me shkronja të mëdha ka funksion emfatik dhe është pjesë e një mikroteksti pragmatik me natyrë normative dhe autoritare.

Students may also bring an owl OR a cat OR a toad PARENTS ARE REMINDED THAT FIRST YEARS ARE NOT ALLOWED THEIR OWN BROOMSTICKS (HPHS, p. 72)	Nxënësit mund të sjellin edhe një buf, OSE një mace, OSE një zhabë <i>U KUJTOJMË PRINDËRVE SE NXËNËSVE TË VITIT TË PARË NUK U LEJOHET PËRDORIMI I BISHTAVE VETJAKE TË FSHESAVE (HPGF, fq. 58)</i>
---	---

Në shembullin e mësipërm, lidhëza OR në gjuhën burimore dhe lidhëza OSE në gjuhën e përkthimit janë dhënë me shkronja të mëdha për të theksuar idenë se nxënësit mund të marrin me vete vetëm njërin prej kafshëve të buta, pra, jo më shumë se dy syresh. Fjalja që vjen më pas përcjell një urdhër të prerë të rregullores së shkollës dhe si e tillë, është shkruar me shkronja të mëdha. Vëmë re se, edhe në gjuhën e përkthimit, është ruajtur i njëjti element grafik.

“Silence! SILENCE!” Snape roared. “Anyone who has been splashed, come here for a Deflating Draught — when I find out who did this —” (HPCS, p. 197)	Qetësi! QETËSI!- bubullonte Pitoni. Të gjithë ata që janë goditur nga stërpikat, të vijnë tek unë që t’i Shfryj. Po ta kap atë që e bëri...(HPDF, fq. 153)
---	---

Shembulli tjetër i sjellë më sipër na tregon një ndryshim të tonit të folësit. Nëse do ta dëgjoni personazhin duke folur, do të vini re ngritjen e volumit të zërit për të treguar një përshkallëzim të gjendjes së tij emocionale.

Dy shembujt e mëposhtëm tregojnë shprehjen e mllefrit nga ana e folësit me një ton të ashpër dhe kanë efekt akustik:

Shembulli 1

“WHAT HAVE I TOLD YOU,” thundered his uncle, spraying spit over the table, “ABOUT SAYING THE ‘M’ WORD IN OUR HOUSE?” “But I —” “HOW DARE YOU THREATEN DUDLEY!” roared Uncle Vernon, pounding the table with his fist. “I just —” “I WARNED YOU! I WILL NOT TOLERATE MENTION OF YOUR ABNORMALITY UNDER THIS ROOF!”(PHCS, p. 2)	A S’TA PATA THËNË? – ofshani xhaxhai i tij, duke stërpikur me pështymë tërë tryezën. – NË KËTË SHTËPI NUK DUA TA DËGJOJ FJALËN MAGJ...Nuk dua TA DËGJOJ! Por unë...-DHE SI GUXON TA KËRCËNOSH DADLIN? – gjëmoi xhaxha Vernoni po me atë vrazhdësi, duke shembur grushtin mbi tryezë. TA KAM THËNË! NUK DUA TË NXJERRË KRYE NË KËTË STREHË GJENDJA JOTE ASPAK NORMALE! (PHDF, fq. 8)
--	--

Shembulli 2

“What’s a Howler?” he said. He thought for a moment it <i>had</i> exploded; a roar of sound filled the huge hall, shaking dust from the ceiling. “— STEALING THE CAR, I WOULDN’T HAVE BEEN SURPRISED IF THEY’D EXPELLED YOU, YOU WAIT TILL I GET HOLD OF YOU, I DON’T SUPPOSE YOU STOPPED TO THINK WHAT YOUR FATHER AND I WENT THROUGH WHEN WE SAW IT WAS GONE —” (HPCS, p. 92)	Ç’është letra ulëritëse? - pyeti. Aty për aty iu duk sikur letra plasi: sallën e gjerë e mbushi një ulërimë luani, aq sa nga tavanin nisi të binte pluhur. ...TË VJEDHËSH MAKINËN! NUK DO TË ÇUDITESHA ASPAK SIKUR TË TË PËRZININ! PRIT PA TA TREGOJ UNË! NUK MENDOVE ASFARË SE Ç’HOQËM, YT ATË DHE UNË, KUR PAMË SE NUK ISHTE MË ATY... (HPDF, fq. 74)
---	---

Një ndër objektet magjike në botën e magjistarëve është edhe letra ulëritëse, e cila iu dërgua Ronit nga nëna e tij, pasi Roni dhe Harri kishin vjedhur makinën fluturuese. Ata kishin thyer rregullat dhe kjo gjë e kishte xhindosur nënën e Ronit dhe i gjithë ky mllef i saj del me zë ulëritës kur Roni hapi zarfin. Ky efekt akustik është pasqyruar me shkronja të mëdha, kursive dhe me shkronja të zeza në gjuhën burimore. Në gjuhën e përkthimit e gjejmë vetëm me shkronja të mëdha. Megjithatë, efekti “ulëritës” i tekstit është përcjellë edhe në gjuhën e përkthimit.

Analiza kontrastive: Përdorimi i përsëritjes së të njëjtës shkronjë

Përsëritja e së njëjtës shkronjë shërben si informacion plotësues gjatë ligjëritimit të personazheve, dhe në rastin e mëposhtëm shoqërojnë ndjenjën e druajtjes, ngurrimit ose, në rastin e përsëritjes së zanoreve të shoqëruara edhe me shkronja të mëdha, ka efekt akustik apo zgjatje të zërit gjatë ligjëritimit bisedor.

Dudley stumbled backward at once, a look of panic on his fat face. “You <u>c-can’t</u> — Dad told you you’re not to do <u>m-magic</u> — he said he’ll chuck you out of the house — and you haven’t got anywhere else to go — you haven’t got any <i>friends</i> to take you —” “<i>Jiggery pokery!</i>” said Harry in a fierce voice. “<i>Hocus pocus — squiggly wiggly —</i>” “<u>MUUUUUUM!</u>” howled Dudley, tripping over his feet as he dashed back toward the house. “<u>MUUUUUM!</u> He’s doing you knowwhat!” (PHCS, p. 10)	Dadli u zmbrops në çast dhe u pengua, me fytyrën që i shprehte tmerr:-<u>T-ti</u> nuk mund ta bësh...Babai <u>t-të</u> ka thënë se nuk mund të bësh <u>m-mag-ji...k-ka</u> thënë se do të përzejë nga <u>sh-shtëpia</u>....dhe ti nuk ke ku të shkosh... nuk ke <i>shokë</i> që të të strehojnë... -“<i>Nomen Omen!</i>” – shqiptoi Harri me një zë të thellë. – <i>Hokus Pokus...Arti Morti...</i>” - <u>Mama moj!</u> – bërtiti Dadli, duke u penguar në këmbët e veta, teksa po vërsulej drejt shtëpisë. <u>Mama</u>, Harri se ç’po bën aty! (HPDS, fq. 13)
--	---

Në shembullin e mësipërm kemi një dialog midis Harrit dhe Dadlit ku, ky i fundit është i tmerruar nga frika se mos Harri i bën ndonjë magji. Frika që ai po përjeton, shprehet me ngurrim në shqiptimin e fjalëve, të cilat në roman ilustrohen me këto efekte grafike të përsëritjes së shkronjave të kombinuara me

përdorimin e shkronjave të mëdha. Vërejmë se ky efekt stilistikor është ruajtur edhe në gjuhën e përkthimit.

Analiza kontrastive: Përdorimi i tre pikave (...)

Një tjetër shenjë pikësimi me efekt kuptimi plotësues janë edhe tre pikat, të cilat mund të shprehin ngurrim, ndryshim të gjendjes emocionale, suspancë, apo ndonjë mendim që të kalon në kokë. Rami Memushaj në librin e tij, “Shqipja Standarde, si ta flasim dhe ta shkruajmë” përmend këto funksione të kësaj sinjalistike pikësimi: a) kur fjalët e folësit ndërpriten nga bashkëbiseduesi apo diçka që ndodh papritmas; b) për të treguar ndërprerjen e thënies nga vetë folësi, për arsye të ndonjë ndjenje të fortë, kur nuk e gjen dot fjalën e duhur, kur nuk mund të flasë, kur ngurron ose ndërron mendje; c) për të treguar të folur me ritëm të ngadaltë e me pushime të gjata; d) për të treguar ndërprerjen e një thënieje që lexuesi e merr vetë me mend; e) në vend të një fjale që nuk duam ta përmendim, ose në shkrimet e fjalëve që, për një arsye ose një tjetër, nuk i japim të plota; f) kur ligjërimi ka mbaruar, por folësi nuk i ka thënë të gjitha; g) në citime për të treguar se janë lënë jashtë pjesë, fjali, fjalë.”⁸

Shkrimtarët mund t’i përdorin tre pikat për të treguar një pauzë, apo një riformulim të një fjalie. Kjo shenjë grafike, ashtu si edhe shenjat e tjera, janë shumë të shpeshta në gjuhën burimore të korpusit tonë dhe kryesisht sinjalizojnë ngurrim, apo mungesë elokuence nga ana e folësit.

“Yer ticket fer Hogwarts, “ he said. “First o’ September -- King’s Cross -- it’s all on yer ticket. Any problems with the Dursleys, send me a letter with yer owl, she’ll know where to find me.... See yeh soon, Harry.” (HPPS, p. 93)	“Këtu ke biletën për në Hoguorts” i tha. “Më 1 shtator, në King’s Kross ... i ke të gjitha të shkruara në biletë. Në paç probleme me Dërsllit, nismë një letër me kukuvajkën tënde, ajo e di ku mund të më gjejë ... Mirupafshim, Har-ri”. (HPGF, fq. 74)
---	---

8 R. Memushaj, *Shqipja Standarde, si ta flasim dhe ta shkruajmë*. Tiranë: Botimet TOENA, 2011. Fq. 202 – 203.

Siç e shohim edhe nga shembujt e mësipërm, ndeshemi me një larmi tiparesh ortografike, të cilat përcjellin kuptime plotësuese të konteksteve në të cilat përdoren, duke e ndihmuar lexuesin të arrijë të kuptojë ngjyrimet mbisegmentale. Vërejmë se edhe në gjuhën e përkthimit janë përcjellë të njëjtat efekte.

Përfundime

Siç edhe u dëshmua gjatë analizës, tiparet mbisegmentale të shprehura në mjetin e komunikimit të shkruar me anë të grafikës, gjenden në forma dhe funksione të larmishme. Në letërsinë për fëmijë, ato kanë një rëndësi të veçantë pasi shprehin kuptime konotative plotësuese e orientuese për lexuesit e vegjël dhe u shtojnë atyre kënaqësinë e leximit. Tiparet grafike më të shprehura në korpusin Harry Potter janë ndryshimet dhe kundërvëniet e llojeve të shkrimeve me qëllim sinjalizimin e ndryshimit të stileve brenda makrotekstit, fjalë dhe fjali me shkronja të mëdha për të treguar tonin e zërit të folësit dhe përkatësisht edhe gjendjen e tij emocionale, shkronjat kursive për t'iu referuar termave magjike dhe neologjizmave të cilat iu kundërvihen termave të gjuhës standarde, përsëritja e së njëjtës shkronjë për të shprehur hutim nga ana e folësit/personazhit, tre pikat për të treguar ngurrim etj. Të gjitha këto shtresime kuptimore nuk duhet të lihen pa u vënë re nga përkthyesi, i cili duhet të përpiqet të gjejë mjete grafike në gjuhën e përkthimit të cilat të përcjellin të njëjtin efekt që ato krijojnë te lexuesi i gjuhës burimore.

Për sa u përket barasvlerësve të tyre në gjuhën e përkthimit, mund të themi se në përgjithësi imazhet grafike janë përcjellë duke mbartur me vete edhe konotacionet dhe shtresimet kuptimore. Zëvendësimi formal i tyre në gjuhën e përkthimit nuk është gjithmonë i rekomandueshëm pasi edhe mjetet grafike, në veçanti shenjat e pikësimit mund të reflektojnë tipare idiolektore të autorit, duke iu kundërvënë rregullave konvencionale të tyre. Përkthyesi duhet t'i evidentojë fillimisht këto kundërvënie dhe të kuptojë funksionin e tyre. Më pas, ai duhet të analizojë faktin nëse e njëjta formë do të përcillte të njëjtin efekt në gjuhën e përkthimit. Kjo është edhe arsyeja se përse në disa raste përkthyesi ka përdorur mjete alternative për të përcjellë të njëjtin efekt.

Si përfundim, mund të themi se tiparet mbisegmentale luajnë një rol të rëndësishëm në përcjelljen e shtresimeve kuptimore dhe gjendjes emocionale të personazheve gjatë ligjërimit dhe, si të tilla, meritojnë vëmendjen e studiuesve.

BIBLIOGRAFIA:

- COLLINS, BAND MEES, I.M. (2013), *Practical Phonetics and Phonology: A Resource Book for Students*, 3rd ed. Routledge.
- EDWARD, H.T. (2003), *Applied Phonetics: The Sounds of American English*. Cengage Learning.
- DAVID, C. (2008), *Dictionary of Linguistics and Phonetics*, 6th ed. Blackwell.
- MEMUSHAJ, R. (2011) *Shqipja Standarde, si ta flasim dhe ta shkruajmë*. Tiranë: Botimet Toena.
- NORD, C. (2005), *Text Analysis in Translation: Theory, Methodology, and Didactic Application of a Model for Translation-Oriented Text Analysis*, Amsterdam: Rodopi.
- LLOSHI, XH. (2005), *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*. Tiranë: Albis.
- VARGA, L. (2010), *Introduction to English Linguistics A Companion to the Seminar*, Eötvös Loránd University Budapest.

KORPUSI LETRAR:

- ROWLING, J.K. (1997), *Harry Potter and the Philosopher Stone*. London: Bloomsbury.
- ROWLING, J.K. (2002), *Harry Potter dhe Guri Filozofal*. (përkthyer nga Amik Kasoruh) Tiranë, Shtëpia Botuese Dituria.
- ROWLING, J.K. (1998), *Harry Potter and the Chamber of Secrets*. London: Bloomsbury.
- ROWLING, J.K. (2002), *Harry Potter dhe Dhoma e të Fshehtëave*. (përkthyer nga Amik Kasoruh) Tiranë: Shtëpia botuese Dituria.
- ROWLING, J.K. (2002), *Harry Potter and the Prisoner of Azkaban*. London: Bloomsbury.
- ROWLING, J.K. (2003), *Harry Potter dhe Burgu i Azkabanit*. (përkthyer nga Amik Kasoruh) Tiranë, Shtëpia Botuese Dituria.